KËRKESË
Nr. 4665, datë 28.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Shkozet–Durrës" për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 5 925 340 (pesë milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Shkozet-Durrës"

Nr.	Pronari			Z.K.	NR.PAS	Lloji i pasurisë	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Bujar		Bejolli	8515	1/627	Are	297	95	11780	1119100	Konfirmuar nga ZVRPP
	Mimoza										
2	Yrben	Ndenim	Cekolli	8515	1/190	Are	1410	14	11780	164920	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Idaet		Zyfi	8515	1/188	Are	506	81	11780	954180	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Kujtim	Idaet	Xhaho	8515	1/191	Are	250	76	11780	895280	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Arif		Nezha	8515	1/459	Truall	793	77	11780	907060	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Lush		Ndrevataj	8515	1/203	Are	2000	160	11780	1884800	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE									**5925340**	